

**NJË KONTRIBUT SHUMË ORIGINAL I HISTORIANIT  
HUNAGEZ MBI SHQIPTARËT E BALLKANIN**

(*Antal Molnár, Confessionalization on the Frontiers, The Balkan Catholics between Reform and Ottoman reality; seria Interadria- Culture dell'Adriatico, Viella, Romë, 2019*)

Libri i Antal Molnár "Konfesionalizmi në kufi: Katolikët e Ballkanit në mes Reformës së Romës dhe realitetit otoman", i botuar më 2019 nga Viella në Romë, është gjithçka përveç një libër i zakonshëm historie.

Molnári edhe më herët ka sjellë kontribute të dallueshme për historinë e Ballkanit nga koha e re, duke vjelë burime të panjohura në Vatikan, Dubrovnik e arkiva të Kotorrit, duke qenë drejtor i Akademisë Hungareze në Romë. Tani është drejtor i Institutit të Historisë në Qendrën Hulumtuese për Shkenca Humane në Akademinë Hungareze të Shkencave dhe ligjërues në Universitetin prestigjioz Eötvös Loránd të Budapestit.

Kontributet e tij më të njohura janë: *Le Saint-Siège, Raguse et les missions catholiques de la Hongrie Ottomane 1572-1647* (2004), *The Falconieri Palace in Rome* (2016), në bashkautorësi me Tomás Tóth, si dhe kontribute tjera që kanë të bëjnë me kundërreformacionin dhe historinë e

Ballkanit, ndër to edhe lidhur me veprimtarët katolikë shqiptarë, për çka do të flasim më vonë.

Molnári, i cili vjet dy herë u paraqit para opinionit kosovar, njëherë me rastin e 550-vjetorit të Skënderbeut dhe në promovimin e librit mbi kontaktet historike shqiptaro-hungareze në Akademinë e Shkencave në Prishtinë, është një poliglot që flet italisht, frëngjisht dhe gjuhët sllave të jugut dhe që ka sjellë qasje origjinale në studimin e katolikëve dhe të Ballkanit nën otomanët, duke vjelë arkivat e njohur të Mesdheut, por jo vetëm ata.

Libri para nesh, siç e shpjegon edhe vetë autori në hyrje, është një kompilim esesh të mëhershme i sjellë si një tërësi që prek jetën e katolikëve ballkanikë pas Kundër-reformacionit dhe të jetuarit e tyre në një perandori jokrishtere të kohës, si ajo Otomane.

Dhjetë kapitujt e veprës qëllimshëm janë të përzgjedhur, që si segmente i studiojnë aspektet më kara-

teristike të kohës, që e zbërthejnë një tablo më të gjerë interesante në një mozaik që nga aspektet gjeografike, kulturore, tregtare, politike i kundërvënë në një peshore që i godet stereotipat e vendosur, por edhe sjell shumëçka në një dritë të re të të kuptuarit të fenomenit.

Secili nga kapitujt- esetë është po aq sa tablo në vete, në fakt vetëm edhe një gur në mozaik në të kuptuarit e jetës katolike pas Kundërreformacionit nën otomanët: Françeskanët boshnjakë në mes të centralizmit romak dhe konfesionalizmit ballkanik; Zyra Shejte dhe misionet ballkanike para themelimit të Kongregacionit Propaganda Fide (1622); Venediku Juglindor dhe Hungaria Otomane; Lufta për kapelën në Beograd (1612-1643); Lufta për Kapelën e Novi Pazarit (1527-1630); Misionet katolike dhe origjina e kombkrijimit shqiptar në fillim të shek. XVII; Kisha Ortodokse Serbe dhe përpjekjet për Union me Romën në shek. XVII; Misionet ballkanike nën pontifikatin e Inoqentit XI (1676-1689); *La Schiavona*, vajza boshnjake në mes të hagiografisë katolike dhe transvetizimit femëror ballkanik.

Përtej një formatizmi të etabluar, Molnár sjell brendësime të motiveve dhe prapavijave të ndryshme politike, tregtare, kulturore, interesave dhe lobeve prapa betejave të ndryshme për të kontrolluar postet ipeshkvnore e kishtarë, ndikimin, hierarkinë dhe primatin, sidomos në disa raste që dalloheshin për histori të gjatë rivalitetesh e kontestimesh, sikurse çështja e të parit

në kapelën katolike në Beograd dhe Novi Pazar. Ishte një betejë e ashpër 30-vjeçare e kontestimeve që përfshiu edhe Vatikanin në rivalitetet ndërmjet françeskanëve boshnjakë dhe jezuitëve dhe tregtarëve boshnjakë dhe Dubrovnikut. Dubrovniku ishte çelësi ndërmjet Mediteranit e Kontinentit, ndërmjet Perëndimit e Lindjes dhe katolicizmit e Stambollit. Në fakt, privilegjet që u janë siguruar raguzanëve nga sulltanët u kanë krijuar atyre përparësi të dukshme dhe shpeshherë Roma ishte e vetëdijshme se në këtë aspekt çdo infrastrukturë katolike brenda otomanisë zbërthehet pikërisht përmes dubrovnikasve, të cilët me diplomacinë e tyre subtile, shumë herë hapin dyert në Stamboll për tejkalime situatash. Kjo situatë shpeshherë i konvenon vetë Portës, e cila arbitron në mes katolikëve, në nivel të Stambollit, apo në nivel lokal. Mirëpo, çështja është tjetër kur ndeshen mu këto lobe katolike, madje në aksin jezuit e françeskan boshnjak, apo Raguzë-Venedik.

Françeskanët boshnjakë po ashtu ishin etabluar fuqishëm brenda sistemit otoman dhe si një strukturë katolike e parareformacionit, ata ishin një lloj infrastrukture e një katolicizmi më popullor që të gjendej mënyra e mbijetesës e nganjëherë edhe e bashkëjetesës joortodokse nën otomanët. Një element tjetër shtytës aty ishin edhe zejtarët dhe tregtarët boshnjakë, që ndonëse shumë më pak “kaçik financiar” se raguzanët, filluan të etabloheshin dhe për ta Beogradi - si një qendër që filloi të kishte rëndësi stra-

tegjike e ekonomike në shekujt XVI-XVII, prej nga shpinin kryqëzimet e rëndësishme rrugore e lumore - ishte tejet i rëndësishëm. Ndërsa, interpretimi që ata e kanë të drejtën e emërimit të peshkopit aty, ishte qendrore për ta mbajtur kontrollin e primatin. Por, Dubrovniku, që kishte paratë e ndikimin, me koloninë e tij tregtare, ndonëse më të paktë numerike, ishte dukshëm para dhe e mbante çelësin e pretenduar. Çështja shkoj deri aty sa, në një kundërshti pothuajse 30-vjeçare, involvoi me pa dëshirë arbitrimin tek otomanët, që Roma dëshironte me çdo kusht t'i evitonte.

Në këtë kontest ndërmjet palëve, si pajtues për postin e të parit që do të qëndronte në kapelën e Beogradit dukët se u përdor edhe titulli Ipeshkvi i Prizrenit, që e mbajti Mazreku.

Molnár në fakt zbërthen se prapa gjithë kësaj situatë ilustruese të veprimit të katolicizmit pas Kundërreformacionit në *Otomani*, kishte edhe elemente të tjera shtesë në prapavijë me karakter jo vetëm fetar: përderisa Dubrovniku mbante aksin e tregtisë lindje-perëndim përmes Ankonës (e mbështetur edhe nga Roma), Venediku si kundërshtar e rival u gjet nga boshnjakët që dëshironin ta impononin vijën tjetër paralele të tregtisë dhe ndikimit. Vija e ndikimit venedikas ishte konsistente, por shumë e hollë që shtrihej kryesisht përmes bregdetit në aksin Adriatik-Jon dhe që nuk arriti etablim përtej relievit ballkanik - dhe këtu Molnár në një zbërthim të një qasje të Oliver Shmidtit e tregon këtë dimension të Venedikut

në Ballkan, si “Venediku i Evropës juglindore”.

Roma e kundërreformacionit gradualisht fillon një rivendosi tjetër, duke i konsoliduar radhët, duke sjellë reforma në riorganizim strukturor kishar, por edhe unifikim doktrinash e qëndrimesh që nisën si një përpjekje kundër goditjes së fuqishme të Protestantizmit. Por, një rrezik i tillë nuk ekzistonte në Ballkan nën otomanët. Këtu sfidat ishin tjera. Këtu kishte veprimi në një hapësirë perandorake jokatolike që kishte specificitetet e veta komplekse.

Ajo që Molnári po ashtu vëren është se, ndonëse Kundërreformacioni ishte një lëvizje kundëroffensive katolike. Shpejt u kuptua nga Vatikani i shekujve XVI-XVII që evangelizimi i jokatolikëve apo katolicizimi i tjerëve nuk ishte agjendë reale dhe se në këtë aspekt, më shumë ka edhe keqkuptime e keqinterpretime të të tjerëve në historiografinë ballkanike. Në këtë duket se ka luajtur rol qendror Pjetër Mazreku, i cili si një relator e vizitator special ka luajtur rol me rëndësi në historinë në fjalë. Mazreku për shumëçka tjetër, më shumë se sa i vlerësuar nga ky kënd në historiorafinë shqiptare, del si një ndikues dhe strategjist ndër kryesorët i ndërtimit të politikave të Kundërreformacionit në Ballkan. Këshillat e tij u treguan largpamëse në shumë drejtime dhe u vënë vulë të veprimeve të Kundërreformacionit dhe katolicizmit në *Otomani*, sikurse edhe e kroatit Mërnaviq, në anën tjetër.

Në fakt, Antal, jo vetëm pëmes Mazrekut, por edhe një plejade klerikësh të lartë që imponohen pas tij, ku hyjnë Budi, Bardhi, Bogdani etj. e bën një prerje interesante që është risi e vërtetë në historiografinë mbi shqiptarët. Ajo thekson se është pikërisht ky lob katolik i Kundër-reformacionit që vënë bazat e identitetit dhe formësimin kombëtar shqiptar para Rilindjes Kombëtare. Molnár, në një mënyrë, ia kundërvë qëndrimin e tij tezës së osmanologut të njohur Kaleshi që sheh kombkrijimin shqiptar të lidhur ngushtë me otomanët dhe islamin. Molnár e thekson rolin e veçantë të këtij lobi katolik shqiptar, i cili në rivalitet të hapur me lobin katolik sllav (“lëvizjen ilire”), lufton për të pasur primatin dhe vendin në vendosje të strukturave, klerarkisë dhe sidomos shkollimit të kuadrove shqiptare në Loreto e gjetiu pas themelimit të *Propagandës Fide*. Një lobi i tillë është në kundërshti me lobin katolik sllav, me ortodoksinë dhe nën trysinë e otomanëve. Shkollimi i kuadrove, botimet shqipe, traktatet polemizuese si ai e Bardhit me Mërnaviqin mbi përkatësinë etnike të Skënderbeut, apo kontributi i Bogdanit për ngritjen e faktorit ushtarak shqiptar gjatë luftës austro-turke, e bënë që kontributi i këtij kombrikijimi shqiptar me primesa katolike të gjejë djepin e saj mu në Kosovë dhe Shqipëri Veriore - thekson Molnár. Dhe kjo lëvizje gjen epilogun mu në Kosovë, pas luftës me shumë pasoja (1689).

Molnari ua kushton një kapitull të veçantë përpjekjeve për Union me Kishën Ortodokse Serbe dhe, sipas tij,

përkundër kontakteve të evidentuara, kjo më shumë ngjan në periferi e në margjina të saj (si hapësira e bregdetit malazias) sesa vërtet ka pasur ndonjë lëvizje të formësuar, që është interpretuar ndryshe në historiografi të ndryshme.

Një pjesë tjetër e kontributit ka të bëjë me hapësirat katolike hungareze nën Perandorinë Otomane dhe rolin që ajo historikisht ka luajtur më vonë kur këto hapësira i janë bashkuar Austro-Hungarisë.

Molnari sjell edhe trajtesa specifike me një qasje origjinale si kapitulli i fundit: *La Shciavona. A Bosnian Girl between Catholic hagiography and female Transvestism*.

Molnari e zbërthen tablonë hagiografike të një vajze boshnjake, Magdalena Peresh Vuksanoviq, që u kundrua si e shenjtë, e cila kishte refuzuar martesën për të jetuar si katolike e devotshme dhe kishte jetuar e maskuar si mashkull, ishte larguar nga Bosnja për në Vojvodinë dhe më vonë në Itali, ku bëhet subjekt i një letërsie hagiografike sipas modës së kohës të *Giovanni Severanos* (1562-1640), një autor shumë i njohur i kohës, që konsiderohet pionieri i arkeologjisë krishtere së bashku me *Antonio Bos-sion*.

Molnari në të sheh një shtresim multidimensional, me primesa ballkanike të transgjinisë, që tek shqiptarët njihet si fenomeni i virgjëreshës dhe që gjetiu ka mbetur edhe te disa popuj malësorë ballkanikë.

Antal Molnár, gjatë dy viteve të kaluara, ka qëndruar dy herë në Ko-

sovë, ku i është paraqitur opinionit shkencor gjatë 550-vjetorit të Skënderbeut dhe me rastin e promovimit të librit mbi kontaktet historike hungarezo-shqiptare.

Ka kaluar i pa hetuar në tërësinë që ai ofron si një nga autorët eksepcional dhe me kontribute të jashtëzakonshme e të reja për historinë e shqiptarëve dhe Ballkanit,

**Ylber HYSA**

